

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 31, datë 28.10.2021


**Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 17,
datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e
administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të
Depozitave”, të ndryshuar**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “ll” dhe shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “i”, të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, si dhe të nenit 8, shkronja “l” të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Komitetit të Investimeve të Agjencisë sipas vendimit të tij nr. 5, datë 17.09.2021, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Në Rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 7, pika 3, togfjalëshi “Kryespecialistin e Sektorit të Analizës së Riskut, në cilësinë e anëtarit” zëvendësohet me togfjalëshin “Përgjegjës in e Sektorit të Analizës së Riskut, në cilësinë e anëtarit”.
 - b) Në nenin 14, pika 1, shkronja “b” ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“b) Transhi i investimit përfaqëson mjetet financiare pasi zbritet transhi i likuiditetit. Ky transh përfshin titujt me maturitet të mbetur deri në 15 vjet. Titujt me maturitet të mbetur mbi 2 vjet



KËSHILLI DREJTUES

nuk mund të kenë një vlerë më të madhe se 30% e totalit të mjeteve financiare për secilin nga fondet. Transhi i investimit duhet të synojë një shpërndarje të shkallëzuar të maturiteteve. Kalimi nga ky transh në transhin e likuiditetit kryhet në përputhje me nevojat e Agjencisë për mjete likuide.”

2. Ngarkohet Komiteti i Investimeve, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës dhe Riskut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar